

Plotësim i
Doracakut për arsimtarë
për notimin formativ
në mësimin klasor

**N O T I M I
F O R M A T I V T E
N X Ë N Ë S I T
M E V Ë S H T I R Ë S I
N Ë M Ë S I M**



Plotësim i
Doracakut për arsimtarë
për notimin formativ
në mësimin klasor

**N O T I M I
F O R M A T I V T E
N X Ë N Ë S I T
M E V Ë S H T I R Ë S I
N Ë M Ë S I M**



Биро за развој на образованието

Shkup, 2015

DORACAK

Titulli:

NOTIMI FORMATIV TE NXËNËSIT
ME VËSHITRËSI NË MËSIM

Botues: Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Për botuesin: mr. Vesna Horvatoviq

Redaktor: mr. Vesna Horvatoviq

Autor: mr. Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska

Recenzentë: mr. Anica Aleksova, mr. Mitko Çeshllarov

Përkthimi në gjuhën shqipe: mr. Satki Ismaili

Dizajni: KOMA

Shtypshkronja: Vinsent Grafika

Tirazhi: 300 ekzemplar

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

37.091.212.6-057.874-056.36(035)

MICKOVSKA, Gorica

Notimi formativ në mësimin klasor : doracak / [autor Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska ; përkthimi në gjuhën shqipe Satki Ismaili]. - Shkup : Byroja e zhvillimit të arsimit, 2015. - 44 стр. : илустр. ; 30 см

-- Notimi formativ të nxënësit me vështirësi në mësim : plotësim i Doracakut për arsimtarë për notimin formativ në mësimin klasor. - 15 str. : tabeli ; 30 см

ISBN 978-608-206-051-4

1. Tasevska, Andrijana [автор]

а) Ученици со потешкотии во учењето - Методи на проверување - Прирачници

COBISS.MK-ID 99322890

Doracaku është i përpiluar me përkahjen finansiare dhe të ekspertëve të Zyrës së UNICEF-it, Shkup.

Botimi është përgatitur me ndihmën profesionale nga Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar.

Qëndrimet e prezantuara në këtë doracak janë të autorëve dhe nuk do të thotë se përputhen me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (BZHA) dhe Qendrës Maqedonase për Arsim Qytetar (QMAQ).

unicef 



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
ГРАЃАНСКО
ОБРАЗОВАНИЕ

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. Notimi formativ i nxënësve me vështirësi në mësim	7
2. Planifikimi i mësimit dhe parashtrimi i qëllimeve të qarta dhe rezultateve të pritura/kriteri për sukses	11
3. Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutimi	17
4. Informata kthyese konstruktive	21
5. Vetënotimi dhe notimi i ndërsjelltë	25
6. Planifikimi në bazë të refleksionit	27
7. Informimi i prindërve	29
8. Shtojcat	31
Shtojca 1 – Vlerësimi inicues – profili i nxënësit/anët e forta – nevoja për përkrahje.....	32
Shtojca 2 – Përshtatja e procesit mësimorë dhe ndjekja e llojeve të ndryshme të pengesave të cilat shkaktojnë vështirësi në mësim	34

HYRJE

Njëri nga qëllimet kryesor të Arsimit inkluziv është krijimi i kulturës dhe sistemit të vlerave në shkollat sipas të cilave vlerësohen të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh dallimet e nevojave të tyre. Inkluzioni duhet ti ridefinojë raportet në shkolla, me çka nxënësit me vështirësi në mësim do të çmohen për ate se çka janë, kundrejt dallimeve të tyre.

Programet e UNICEF-it, Mendo matematikisht në klasat fillestare, shkrimleximi fillestar në klasat fillestare dhe Arsimi inkluziv, japin mundësi të mëdha për përmirësimin e të mësuarit e të gjithë nxënësve. Lidhshmëritë e dy programeve të para me programin Arsimi inkluziv mundësojnë shfrytëzimin e një vargu të strategjive dhe teknikave të cilat e lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, veçanërisht te nxënësit me vështirësi në mësim.

Fëmijët, kohë pas kohe ballafaqohen me vështirësi në mësim dhe në sjellje. Disa lloje të vështirësive, veçanërisht kur fëmiju nuk i plotëson detyrat në përputhshmëri me moshën kronologjike të tij, duhet të merren parasysh si shenja se duhet të kërkohet ndihmë dhe këshilla. Në atë mënyrë mundemi të përfundojmë se a janë në pyetje nxënësit te të cilët në mësimnxënie vështirësitë paraqiten për shkak të ndonjë lloji të pengesës, në realitet grupet e rrezikuara të nxënësve, për të cilët veçanërisht duhet të mundësohet përshtatje e kushteve, metodave dhe teknikave të mesimdhënies, me qëllim që të arrihet përparim optimal. Kjo nuk do të thotë se ndodh diskriminim, ndarje e nxënësve nga këta grupe të rrezikuara në raport me nxënësit e tjerë. Përkundrazi, ju mundësohet përparim në krahasim me vetveten, por në një mjedis në të cilin mësojnë të gjithë nxënësit, me çka është ndihmuar procesi i socializimit.

Sidoqoftë, vazhdimisht bëhet pyetja se si të ndiqen të arriturat te nxënësit pengesat e të cilëve te ta nxisin vështirësi në mësimnxënie? Duke i ditur të gjitha karakteristikat e notimit formativ, ndoshta përgjigje më e thjeshtë dhe më adekuate do të ishte se pikërisht notimi formativ është ajo që është e vërteta në ndjekjen e të arriturave dhe notimit të nxënësve nga këta grupe të rrezikuara, si dhe ajo do të mundëson qasje më të mirë në përparimin e të gjithë nxënësve dhe me ate edhe të nxënësve me vështirësi në mësim. Në realitet, nuk parashtrohet pyetja se a mundet notimi formativ të zbatohet me nxënësit me vështirësi në mësim, por si të zbatohet ai. Me këte hapet edhe një dimension i notimit formativ – llojet e ndryshme të vështirësive kërkojnë mënyra të ndryshme të përshtatjes së mësimdhënies, a me ate edhe të ndjekjes, kontrollimit dhe notimit.

Në këtë doracak nuk do të bëhet fjalë për nxënësit me pengesa në zhvillimin fizik, për shkak se për ta në masë më të madhe është e nevojshme që të përshtaten kushtet në të cilat do të zhvillohet mësimdhënia, ndërsa programet mësimore, qëllimet, standardet, mënyra e ndjekjes së të arriturave dhe notimi janë në masë më të madhe të njëjta sikurse nxënësit e tjerë.

Në këtë doracak do të bëhet fjalë për nxënësit të cilët pengesa shkakton vështirësi në procesin e të mësuarit, dhe se programet, qëllimet dhe rezultatet e pritura, mënyra e mësimdhënies, ndjekja e të arriturave dhe ndonjëherë edhe standardet duhet të përshtaten në kërkesat individuale të nxënësve.

Doracaku ka shtatë pjesë: Notimi formativ i nxënësve me vështirësi në mësim, Planifikimi i mësimin dhe parashtrimi i qëllimeve të qarta dhe rezultatet e pritura/kriteret për sukses, Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutimi, Informata kthyesë konstruktive, Vetënotimi dhe notimi i ndërsjelltë, Planifikimi në bazë të refleksionit dhe Informimi i pirndërve dhe çdo pjesë është plotësim e shtatë pjesëve me tituj të njëjtë të cilët janë në Doracakun për arsimtarë për notim formativ në mësimin klasor.

Pasuri e veçantë e këtij doracaku janë shtojcat:

- ▶ Në Shtojcën 1 është dhënë modeli me shembuj për Vlerësimin inicues të nxënësit (profili i nxënësit – anët e forta dhe nevojat për përkrahje).
- ▶ Në Shtojcën 2 janë dhënë përshtatjet e mundshme të procesit të mësimnxënies dhe ndjekja e llojeve të ndryshme të pengesave të cilat shkaktojnë vështirësi në mësim edhe ate përshkrim i shkurtër i karakteristikave të pengesave (ADHD, Disgrafia, Disleksia, Diskalkulia, Aftësitë intelektuale të zvogëluara dhe Autizmi) dhe për çdo pengesë janë dhënë mundësitë/nevojat për përshtatje, mënyra e ndjekjes dhe notimi i të arriturave dhe teknikat të cilat mund të shfrytëzohen.

Arsimtarëve të cilët do ta shfrytëzojnë këtë doracak ju rekomandojmë, që të shikojnë këtë doracak si plotësim i Doracakut për arsimtarë për notimin formativ në mësimin klasor, ndërsa të dy doracakët t’ju shërbejnë si inspiracion për të gjetur dhe të kyçur në praktikën mësimore vetanake mënyra dhe qasje për të cilat do të jenë të bindur se nxitin më të mirën te çdo nxënës i tyre.

1 Notimi formativ i nxënësve me vështirësi në mësim

NXËNËSIT ME VËSHDIRËSI NË MËSIM

“Sistemi arsimor nuk ka të drejtë ekskluzive në fëmijët e CAKTUAR. Sistemi arsimor është ai i cili duhet të përshtatet për ti kënaqur nevojat e TË GJITHË nxënësve.”

(Linguist, UNESCO, 1994.)

Nxënësit me vështirësi specifike në mësim, në realitet kanë probleme me pranimin, përpunimin ose formimin dhe bartjen e informatave. Në mënyrë primare, këta vështirësi nuk janë të kushtëzuara me pengesa në të pamur, dëgjim ose pengesa motorike, ndikim të rrethit në të cilin fëmiju jeton, probleme të natyrës emocionale, por mund të paraqiten krahas me ta.

Nxënësit me vështirësi në mësim mundet me disa detyra të kenë probleme serioze, ndërsa te disa lloje të t’jera të detyrave të arrijnë sukses. Vështirësitë në mësimnxënie mund të ndikojnë në aftësitë për të lexuar, shkruar, shprehje ose operacione matematikore, dhe se mund të ndikojnë edhe ndaj shkathtësive sociale.

Kështu për shembull, çrregullimi i vëmendjes ose hiperaktiviteti ndonjëherë paraqiten krahas me vështirësitë në mësim, por kjo nuk është gjithmonë në rregull.

Vështirësitë në mësim janë të rradhitura nga më të lehtat, deri të ato mesatare dhe më të vështira, nga ato afatshkurte deri në të përjetshme, dhe për ate për këta nxënës duhet të praktikojmë forma të ndryshme të ndihmës në mësimdhënie dhe në notim të të arriturave të tyre.

Vështirësitë në mësim nuk duhet ti lidhim vetëm me të arriturat arsimore, për shkak se shpesh të nxënësit vërejmë edhe me sa vijnë:

► Aftësi të dobëta organizative (shënime jo në rregull, pamundësia ta planifikojnë dhe organizojnë

“Fëmijët me vështirësi në mësim dallohen ndërmjet vehte – fëmijët e ndryshëm kanë lloje të ndryshme të vështirësive për shkak të shkaqeve të ndryshme.”

(Lerner, 1997)

kohën, haresa e rregullave, detyrave të shtëpisë, mjeteve, vështirësitë me përshkrimin nga tabela ...);

- ▶ Aftësi motorike më pak të zhvilluara (vështirësi gjatë të shkruarit - shpejtësia dhe madhësia e shkronjave, vizatimi, format e ndryshme, manipulimi me mjetet konkretizuese...);
- ▶ Aftësi më të dobëta për integrim social dhe lidhshmëri të vështirësuar dhe komentime të disa shenjave verbale dhe joverbale gjatë komunikimit (sjellje joadekuate, mosrespektim i rregullave, të kuptuarit e gabuar të porosive, ndonjëherë sjellje konfliktuozë të shkaktuara nga frustracionet ...).

Pikërisht për këte, veçanërisht te nxënësit më vështirësi në mësim, mësimdhënia dhe ndjekja e të arriturave nuk ka të bën vetëm me qëllimet arsimore si prioritete.

PSE ËSHTË ME RËNDËSI NOTIMI FORMATIV?

Ajo që është e mirë me nxënësit me vështirësi në mësim, është e mirë për të gjithë nxënësit.

(Meijer, 2003)

Ndjekja e të mësuarit dhe të arriturave të nxënësve me vështirësi në mësim duhet të zhvillohet në të gjitha fazat e punës edukativo-arsimore në kontinuitet, duhet të jetë gjithëpërfshirëse, e fokusuar, analitikisht dhe vazhdimisht duke patur parasysh natyrën e vështirësive të tyre dhe nevojave specifike të tyre. Procedurat për ndjekjen dhe notimin e nxënësve me vështirësi në mësim janë të veçanta në raport me qasjen, përfshirjen dhe maturinë, e cila varet

nga lloji i vështirësive të çdo nxënës në veçanti.

Kështu, programi dhe mënyra e ndjekjes dhe notimit për çdo nxënës, në mënyrë të veçantë përshtaten duke marr parasysh aftësitë kognitive të tij, aftësitë dhe kufizimet e tij, si dhe mënyrën se si nxënësi komunikon, në realitet mund të shprehet.

Vetë ndjekja dhe kontrollimi i të arriturave të nxënësit në lëndë të caktuara, nënkupton të vërejturit, të vërtetuarit dhe vlerësimi i:

- ▶ Shkallës së realizimit të detyrave të parashtruara (shkalla e përvetësimit të diturive dhe operacioneve punuese);
- ▶ Aftësive të përvetësuarra dhe shkathtësive gjatë zbatimit të diturive në aktivitetet dhe situatat e përditshme (përgjegjësi, interesim, aktivitet, pavarësi, përgatitje për punë, komunikim);
- ▶ Shprehitë e fituara për punë (qasja ndaj punës, mjedisi i punës, personalitetet e mjedisit dhe detyrat e parashtruara, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja gjatë procesit të mësimdhënies).

Gjatë kësaj është e domosdoshme që të fitohet pasqyrë e qartë për anët e forta dhe interesin e nxënësit si dhe të zbulohen nevojat e tij në raport me mësimin. Mënyrat dhe

format e ndjekjes së të arriturave duhet të jenë të orientuara nga procesi i të mësuarit, të përshtatura për nxënësin dhe aftësitë e tij, të veprojnë afirmativisht dhe në mënyrë nxitëse, me çka do të mundën në mënyrë kualitative të shfrytëzohen aftësitë më të zhvilluara dhe të zhvillohen aftësi të reja.

Notimi me shkrim është mënyra më e mirë për notim, në realitet prezantimi i të arriturave të nxënësve me vështirësi në mësim, për shkak se në atë mënyrë sigurohet informatë më e mirë për atë se çka është aritur (janë përshkruar të gjitha elementet e lartëpërmendura të cilat janë ndjekur), si është përparimi në periudhë të caktuar dhe veprohet në mënyrë stimulative ndaj vetërespektimit, ndjenjës për sukses dhe zhvillimit githëpërfshirës të personalitetit të nxënësit.

SI TË REALIZOHET NOTIMI FORMATIV?

Fëmiu duhet të ndjejë se: është me rëndësi, e dëgjojnë, në te besohet, për te kujdesem.

Gjatë notimit formativ të nxënësit me vështirësi në mësim duhet të kemi kujdes në specifika të caktuara në mënyrën e ndjekjes së të arriturave të nxënësit.

Në këtë drejtim:

- ◆ Mundësoni kohë më të gjatë se zakonisht, për zgjidhje me shkrim të disa detyrave;
- ◆ Materialin e shkruar ndonjëherë do të duhet ta përshtatni në mënyrë përkatëse (të *zmadhohet hapësira ku do të shënohet përgjigjja, nëse nxënësi nuk mundet të shërbehet me veglat gjeometrike ti mundësohet të bën skica me dorë të lirë ose ti ofrohen disa vizatime nga të cilat do ta zgjedh dhe shënon të saktën ose nga seria e e vizatimeve të bën varg sipas rradhitjes së punimit*);
- ◆ Gjatë të shprehurit gojor me durim pritni përgjigjen;
- ◆ Në rast se nxënësi ka vështirësi në të shprehurit, mos e ndërpritni dhe mos i sygjeroni përgjigje;
- ◆ Në rast se punohet për fëmijë me vështirësi në lexim më së shpeshti praktikoni komunikim gojor ose lexoni detyrën që të mundet ti përgjigjet asaj;
- ◆ Metoda të ngjashme mund të shfrytëzoni kur bëhet fjalë për vështirësi në të shkruar dhe vështirësi në përvetësimin e matematikës.

Kur punohet sipas programeve individuale, ndjekja e të arriturave duhet të bën në atë se çka është paraparë me ato programe:

- ◆ Përshtatni qëllimet dhe rezultatet duke shfrytëzuar materiale të njejta për punë, në rast se kjo nuk ka sukses atëherë siguroni udhëzime dhe materiale të ndryshme me të cilat do të plotësohen nevojat individuale të nxënësit;

- ◆ Në rast se punohet për nxënës me koncentrim të dobët, kontrolloni dituritë më shpesh, në intervale më të shkurta kohore dhe me numër më të vogël të detyrave, pyetjeve ose kërkesave;
- ◆ Në rast se bëhet fjalë për nxënës me pengesa perceptivë është e nevojshme që materiali punues të jetë i thjeshtë, pa elemente të panevojshme plotësuese dhe të punohet pjesë - pjesë.

NDJEKJA DUHET TË JETË:

- ▶ **Gjithëpërfshirëse**, nëpër situata të ndryshme, aktivitete dhe forma të punës (punë e pavarur, punë me material të shkruar, të shprehurit gojor, puna në grupe, puna praktike, puna me lloje të ndryshme të detyrave ...),
- ▶ **Parimore** në aspektin e ndjekjes dhe kontrollimit të detyrave të realizuara, respektimit të rregullave, realizimit të aktiviteteve ... ,
- ▶ **Në kontinuitet**, çdo ditë, me qëllim që me kohë të vërehen nevojat e nxënësit,
- ▶ **E dokumentuar**, rezultatet e ndjekjes (përcjelljes) duhet vazhdimisht që të shënohen, në realitet të ndiqet dhe shënohet suksesshmëria e përvetësimit të përmbajtjeve shpesh dhe në periudha kohore të shkurta, dhe ti jepet informatë kthyesë nxënësit (dhe prindit) dhe për përparimin më të vogël.

Dobësia jonë më e madhe është heqja dorë, ndërsa rruga më e sigurtë për të arritur deri te suksesi është që të mundohemi së paku edhe njëherë.

(Tomas Edison)

Mirë është të zhvilloni sistemin tuaj të përcjelljes, të përshtatur në nevojat e nxënësit. Me përshtatjen e nevojave për punë dhe qasjen e individualizuar zvogëlohet ndjenja për mosndihmë, ndërsa nxënësi mëson çdo ditë sipas tempos së tij dhe përparon në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore sipas mundësive të tij me ndihmë nga ana e arsimtarëve dhe prindërve dhe shpesh edhe nga nxënësit e tjerë.

Të arriturat e tij nuk krahasohen me të arriturat e nxënësve të tjerë.

Përparimi i tij shihet në raport me vetveten – ku ka qenë dhe ku ka arritur tani.

2 Planifikimi i mësimit dhe parashtrimi i qëllimeve të qarta dhe rezultateve të pritura/kriteri për sukses

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Nuk ekziston plan univerzal arsimor individual.

Ai duhet të bazohet në aftësitë e anëve të forta të nxënësit për të cilin bëhet.

Nxënësve me vështirësi në mësim shpesh ju nevojiten plane arsimore individuale në të cilat janë kyçur prioritete të cilat janë mbi prioritetet në planet dhe programet mësimore të cilat zakonisht përdoren në shkolla.

Planifikimi individual mund t'ju ndihmon arsimtarëve:

- ▶ Ti identifikojnë anët e forta të nxënësit dhe vështirësitë në procesin e përvetësimit të diturive;
- ▶ Ti revidojnë vështirësitë paraprake dhe përparimin;
- ▶ Ti përcaktojnë në mënyrë më konkrete qëllimet afatshkurte lidhur me nevojat prioritare të nxënësit;
- ▶ Të parashtrajnë qëllime për vitin e ardhshëm shkollor;
- ▶ Ti kyçin nxënësit, prindërit dhe profesionistët e tjerë në procesin e planifikimit dhe përcjelljes.

Nxënësit me vështirësi në mësim do të kenë dobi nga zhvillimi në spektrin më të gjërë të aftësive, të cilat në mënyrë të përafërt janë lidhur me të mësuarit. Ata kycin:

- ◆ aftësinë për komunikim
- ◆ zbatimin e shkathtësive të lidhura për shfrytëzimin e numrave
- ◆ aftësitë për punë me të tjerët
- ◆ shkathtësitë për organizimin dhe përvetësimin e diturive dhe përmirësimin e të mësuarit vetanake
- ◆ aftësitë për të menduarit dhe shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve
- ◆ aftësitë perceptive
- ◆ aftësitë për orientim, lëvizje dhe shkathtësi fizike
- ◆ aftësi për vetkujdesje, udhëheqje me sjellje dhe emocionet vetanake
- ◆ aftësitë e lidhura për jetën e përditëshme, duke e kyçur edhe aftësitë për kujdesin e shtëpisë dhe jetës në bashkësi
- ◆ aftësitë për organizimin e kohës së lirë dhe rekreativitetin

Këta aftësi dhe shkathtësi nuk varen nga lëndët mësimore dhe zbatohen në shumë situata në programet mësimore dhe në jetën në shkollë dhe jashtë shkollës. Qëllimet që duhet të realizohen në lidhje me këta shkathtësi mund të futen në planet arsimore individuale me çka do të realizoheshin edhe prioritetet të cilat kanë të bëjnë me mësimin.

(Приручник за наставу, УНИЦЕФ, Дуга, Сарајево, 2009)

Bërja e planifikimit individual zhvillohet në tre hapa:

1. **Vlerësimi inicues**, e cila në realitet do të thotë edhe formim i profilit pedagogjik të nxënësit (*Shtojca 1*), dhe përbëhet nga:

Planifikimi individual nuk do të thotë vetëm të ngushtohen dhe kufizohen qëllimet, të priturat dhe përmbajtjet mësimore, por edhe të njejtat të përshtaten për nevojat e nxënësit dhe të zgjidhen strategji dhe metoda përkatëse për mësimdhënie dhe ndjekje të të arriturave.

- ◆ **Grumbullimi i të dhënave për nxënësin** – të dhënat në fillim merren nga prindërit e nxënësit, por gjatë kohës së mësiminut edhe nga vetëarsimtarët në bazë të observimeve, nga bashkëpunëtorët profesional dhe nga vetë nxënësi.

- ◆ **Përcaktimi i shkallës momentale të të arriturave**, që kyç sintetizimin e të dhënave nga vlerësimet në fusha të ndryshme: gjuhë, matematikë, zhvillim social dhe emocional, shkathtësi që kanë të bëjnë me kujdesin për veten, komunikim... Vërejtjet të cilat kanë të bëjnë me shkallën e të arriturave, është mirë që të jenë sa më shumë e mundur më precize për

shkak se në realitet ata shpiejnë nga parashtrimi i qëllimeve dhe rezultateve të qarta, konkrete dhe të matëshme që njëkohësisht arrihen

Për shembull, më së miri është që të vërehet:

“Pranon pjesëmarrjen në lojëra grupore dhe i respekton rregullat e lojës“

se sa

“Ka të zhvilluara mirë shkathtësitë sociale“.

Deklarata për shkallën e të arriturave plotëson dy funksione të rëndësishme:

- ▶ Jep bazë për identifikimin e nevojave prioritare gjatë mësimin dhe përcaktimin e qëllimeve reale dhe të realizueshme;
- ▶ Mundëson ndjekje dhe kontrollim të përparimit.

Në këtë mënyrë mund të përgatitet profil i qartë i funksionimit momental të nxënësit nga çka do të vërehen anët e forta të tij, aftësitë dhe shkathtësitë dhe të njëjtat do të mundën të shfrytëzohen në procesin e mësimdhënies. Njëkohësisht, nga këtu dalin edhe prioritetet e nevojshme lidhur me vështirësitë në mësim.

2. Përcaktimi i prioriteteve të nevojshme është të përcaktuarit e lëmive në të cilat intervenimet janë më të nevojshme dhe më të rëndësishme. Nevojat prioritare janë bazë për definimin e qëllimeve dhe rezultateve dhe paraqesin atë se çka pritët nga nxënësi që të arrijnë në periudhë jo më të gjatë se një vit shkollor. Nevojat prioritare në mësim për nxënësin përcaktohen vetëm për ato lëmi në të cilat ai ka vështirësi, gjatë së cilës duhet patur kujdes që numri i tyre të jetë real.

Gjatë përcaktimit të prioriteteve ndonjëherë shumë me rëndësi është që në fillim të krijohen kushte që nxënësi të jetë i suksesshëm në ndonjë aktivitet, me çka do të rritet niveli i vetëbesimit dhe vetërespektimit, dhe pastaj të punohet në realizimin e ndonjë qëllimi të caktuar arsimor.

Gjatë përcaktimit të prioriteteve të nevojshme duhet të merren parasysh:

- ◆ shkalla momentale e të arriturave të nxënësit,
 - ◆ anët e tij të forta dhe nevojat e veçanta të tij,
 - ◆ shpejtësia me të cilën përparon nxënësi,
 - ◆ shpejtësia e nevojave të nxënësit në lëmi të caktuara mësimore,
- ◆ rëndësia e atyre nevojave mësimore të cilat i kemi shfletuar si prioritete,
 - ◆ motivimi dhe interesi i nxënësit.

Plani dhe programi për përkrahje për nxënësit me vështirësi në mësim duhet vazhdimisht që të revidohet, plotësohet, ndryshon si rezultat i përndjekjes, në realitet të përmirësohet dhe të përshtatet në nevojat individuale të nxënësit.

3. Përgatitja e planit/programit për përkrahje

- ◆ **Parashtrimi i qëllimeve dhe rezultateve** për nevojat prioritare

Planet individuale duhet të përmbajnë numër të vogël (3-6) të qëllimeve afatshkurte të cilat janë specifike për atë nxënës dhe mund të arrihen në disa (5-6) javë. Përparimi në raport me qëllimet individuale duhet të jetë lëndë e ndjekjes së të arriturave të nxënësit. Qëllimet tregojnë në

rezultatet e pritura ose në të arriturat të cilat priten pas periudhës së planifikuar për të cilin bëhet plani arsimor individual.

Rezultatet janë pohime pozitive me të cilat përshkruhet sjellja e cila mund të observohet, në realitet shkathtësitë ose e gjithë ajo që do të ndodh gjatë kohës ose realizimit të planifikimit individual, ose flasin për atë se çka presim që nxënësi mund të bën pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies.

Qëllimet dhe rezultatet mund të jenë afatshkurte (javore, mujore) ose afatgjate (gjysmëvjetore, vjetore). Qëllimet e definuara mirë janë të qarta, konkrete, të arritshme dhe të matshme. Arritja e qëllimeve nuk duhet të shikohet vetëm në raport me mundësitë e nxënësit, por edhe në raport të mundësive reale të prindërve dhe shkollës që të angazhohen në nxitjen e zhvillimit të fëmijut. Qëllimet e parashtruara në nivel të lartë mund të shkaktojnë stagnim dhe regresion në zhvillimin e fëmijut dhe të ndikojnë negativisht ndaj vetëbesimit dhe motivimit.

Qëllimet, veçanërisht rezultatet, të cilat i parashtrojmë në mënyrë individuale për çdo fëmijë me vështirësi në mësim duhet të jenë sa që është e mundur të përshkruara më detajisht, specifike enkas për atë nxënës për të cilin janë të përkushtuar dhe është e preferueshme të jenë afatshkurte me çka do të ndiqet më lehtë përparimi dhe do të bëhen përmirësime në raport me qasjen në mësimdhënie.

Shembuj për qëllimet dhe rezultatet e parashtruara

QËLLIMET	REZULATET
Nxënësi të mëson që ti dëgjon të tjerët (nxënësit të tjerë, arsimtarët, prindërit).	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Do ta shikon atë kush i flet. ◆ Nuk do të bën asgjë tjetër deri sa tjetër kush flet, kyçje dhe ndërhyrje në bisedë. ◆ Do të mund të përsërit atë që e ka thënë tjetri.
Nxënësi të lexon kuptueshëm.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Do të mund të lexon tekst nga 5 fjali. ◆ Do të mundet ta shpjegon tekstin në atë mënyrë që do ti përmend personazhet kryesore dhe ngjarjet kryesore.
Nxënësi ti kupton operacionet më të thjeshta matematikore.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nga katër detyra të dhëna të thjeshta me mbledhje dhe zbritje të numrave dyshifrorë deri më 100, nxënësi në mënyrë të saktë i zbaton operacionet në më së paku dy detyra.

Nëse fëmiju nuk mund të mëson në atë mënyrë se si e mësojmë ne, duhet ta mësojmë në atë mënyrë se si mund të mëson ai.

(Приручник о дислексији, дисграфији и сличним тешкоћама у читању, писању и учењу, 2005)

◆ **Përcaktimi i mënyrave të mësimdhënies:**

Me rëndësi të veçantë është bërja e përshtatjes së kushteve në të cilat do të zhvillohet mësimdhënia si dhe i strategjive dhe i teknikave të mësimdhënies së nevojave individuale të nxënësit të lidhura me karakteristikat e gjendjes që ka shkaktuar vështirësi në mësim.

Për atë gjatë planifikimit duhet të precizohen:

- ▶ me ndihmën e cilës detyrë/aktivitet do ti arrijmë qëllimet dhe rezultatet e planifikuara,
- ▶ cilat materiale do ti kemi të domosdoshme dhe nga kush do të presim përkrahje,
- ▶ në cilën kornizë kohore presim që të rrjedhin realizimet e qëllimeve.

Gjatë përcaktimit të mënyrave të mësimdhënies keni parasysh si prioritet nevojat e veçanta të nxënësit, por njëkohësisht mendoni se si aktivitetet e planifikuara do të përshtaten në aktivitetet të cilat i planifikoni me nxënësit e tjerë në kohën e dhënë.

4. Ndjekja, vlerësimi dhe notimi

Siç është me rëndësi që të bëhet përshtatja në raport me mësimdhënien, gjithashtu është e domosdoshme që të bëhet përshtatja edhe e mënyrave të ndjekjes së të arriturave, në realitet të planifikohen metodat, mënyrat e notimit formativ dhe të gjitha atyre procedurave të cilat shpiejnë nëpër procesin e mësimin, dhe njëkohësisht tregojnë për shkallën e përparimit të nxënësit. (*Shtojca 2*)

3 Parashtrimi i pyetjeve dhe diskutimi

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Llojet e ndryshme të vështirësive e zvogëlojnë mundësinë e nxënësit që në mënyrë konvencionale, të zakonshme dhe të njohur, ti tregojnë nevojat dhe të arriturat e veta.

Si të parashtrihen pyetjet efektive të kushtuara për të gjithë nxënësit në klasë? A do të mundën nxënësit me vështirësi në mësim t'ju përgjigjen pyetjeve të këtilla? A nuk do të ndjehen të pasuksesshëm dhe të tërhiqen në vetvete? A duhet dhe si të përshtaten pyetjet?

PARASHTRIMI I PYETJEVE NGA ANA E ARSIMTARIT

Kur parashtrojmë pyetje të cilat janë për të gjithë nxënësit, kemi mundësi që ti drejtohem ndonjë nxënësi të caktuar dhe pyetjen ta bëjmë më specifike, në realitet ta përsërisim – me atë që përmbajtja do të jetë e njejtë, por kërkesat do të jenë në pajtim me rezultatet e parashtruara individuale për nxënësin. Me këtë në realitet do ta thjeshtësojmë nivelin e komplikueshmërisë të kërkesës dhe do ta vendosim në nivel të proceseve mendore më të thjeshta (njohje, të kuptuarit).

Shembull:

Si do ta sqaroni sjelljen e vajzës në tregim? (analiza)

Çka bëri vajza në fillim të tregimit? (dituri) Pse? (të kuptuarit)

- ▶ Filloni me pyetje të llojit të mbyllur në të cilat kërkohen përgjigje të thjeshta për ti motivuar, pastaj vazhdoni me

pyetje të hapura të cilat edhe juve do t'ju sqarojnë se si nxënësi shikon në ate çka ka bërë por njëkohësisht do të mundësojnë që vetë nxënësi ta përsërit procedurën të cilën e ka kryer.

- ▶ Shfrytëzoni lloje të ndryshme të pyetjeve, si psh.: **Çka mundesh më tepër të më tregosh për këtë?, Si e bën ti këtë?, Pse kjo është e njejtë/ndryshe?, çka do të ndodh nëse ...?, Si do t'ia sqarosh ti këtë ndonjërit më të vogël se ti?, Pse mendon ashtu?, Pse është kjo më mirë se?**
- ▶ Praktikoni në masë të madhe të parashtroni pyetje gojore dhe të merrni përgjigje gojore. Nxënësit me vështirësi në mësim shpesh kanë problem me të kuptuarit e këkresave të parashtruara me shkrim ose me të shprehurit me shkrim gjatë përgjigjes të pyetjeve.
- ▶ Kur parashtroni pyetje me shkrim përshtatni ata në atë mënyrë që të njejtat të jenë të llojit me përgjigje të kufizuar, në realitet pyetje nga të cilat pritet përgjigje e shkurtë she konkrete, si për shembull:
- ▶ **Pse (në tregim) vajza qau?**
- ▶ **Kush i ndihmoi gjyshit të**

Në rast se nga nxënësi nuk fitoni reaktion/përgjigje, nxitni në mënyrë fizike që bashkërisht ta realizoni aktivitetin – udhëhiqni ate në aktivitet, mos pritni t'ju imiton, mos sqaroni dhe flisni vazhdimisht, tregoni atij si duhet. Me ate do ti ndihmoni nxënësit të din se çka kërkoni nga ai.

(Јакубовиќ Е., 2013)

▶ Vështirësitë në mësim mund të jenë rezultat i koncentrimin të zvogëluar ose i mungesës së vëmendjes. Për ate, përsëritni pyetjen e parashtruar më tepër herë. Gjatë kësaj afrohuni te nxënësi më afër, vendosni kontakt me sytë, drejtohuni atij me emër dhe parashtroni pyetjen.

▶ Kontrolloni se a e ka kuptuar nxënësi pyetjen. Ndonjëherë është mirë që të njejtën ta riformuloni.

▶ Nxënësit me vështirësi në mësim shpesh janë të pasigurtë dhe të frikësuar se nuk do të mundën ta japin përgjigjen e kërkuar të pyetjes. Për ate, pyetni edhe kur nuk do ta ngrenë dorën, ndihmoni ata që të

vijnë te përgjigja e kërkuar me çka do të fitojnë siguri më të madhe.

TË PËRGJIGJURIT NË PYETJET E PARASHTRUARA

- ▶ Nxënësve më vështirësi në mësim ju duhet më tepër kohë për dhënien e përgjigjes se sa nxënësve tjerë. Bëhuni të durueshëm, pritni dhe mos e tregoni përgjigjen ju në vend të nxënësit. Siguroni që edhe nxënësit të tjerë të jenë të durueshëm.
- ▶ Në rast se edhe pas kohës së paraparë nuk fitoni përgjigje, udhëhiqni nxënësin me pyetje ndihmëse deri në përgjigjen e pritur. Shpërbleni suksesin e tij me lëvdatë.

- ▶ Te nxënësit me disleksion dhe disgrafi te përgjigjet me shkrim të pyetjeve mos i merrni si jo të sakta përgjigjet e gabuara të cilat janë si pasojë e vështirësive me shkrimlexim. Për ata përshtatni materialin e shkruar (paraqitje me fotografi, organizues grafik, harta kognitive) dhe mundohuni nëpërmjet të pyetjeve plotësuese të parashtruara që të vini deri të përgjigjja.
- ▶ Mos insistoni në përgjigje gojore te ata nxënës të cilët kanë vështirësi me të shprehurit verbal (belbëzim, lënia e shkronjave në fjalë, ndrimi i shkronjës me shkronjë tjetër). Nëse nxënësi duhe të shprehet gojarisht, bëhuni të durueshëm, pritni deri sa të përfundon, punoni edhe te nxënësit e tjerë në ndërtimin e kulturës së secili-secilin ta dëgjon dhe asnjëri-asnjërin mos e qesh.

PARASHTRIMI I PYETJEVE NGA ANA E NXËNËSVE DHE DISKUTIMI

Në përgjigjen e dhënë rindërtoni diturinë – filloni nga ajo që nxënësi e din, bëni aktivitet, lëvizje ose informatë të cilën e din dhe bashkëngjitni me edhe ndonjë të re.

Gjatë kësaj bisedoni, pyetni, nxitni, parashtroni pyetje dhe përgjigjeni në ta.

(Якубовиќ Е., 2013)

- ▶ Jepni vullnet nxënësve që të parashtrojnë pyetje (*shembull: Pyetje interesante ..., çka ende të intereson...*)
- ▶ Nxitni nxënësit që të parashtrojnë pyetje njëri nga tjetri, të përgjigjen në ta dhe ti dëgjojnë idetë e nxënësve tjerë.
- ▶ Ndërtoni në paralele kulturë se nuk ka pyetje të këqia dhe se çdo pyetje meriton përgjigje. Në atë mënyrë edhe pyetjet e nxënësve me vështirësi do të pranohen pa përqeshje.

PYETJET DHE NDJEKJA E PUNËS SË NXËNËSVE

Te nxënësit me vështirësi në mësim me rëndësi të veçantë nuk është vetëm ndjekja dhe evidentimi i suksesit, por edhe ndjekja dhe evidentimi i reagimeve të nxënësit në aktivitete të caktuara, në sjellje dhe në mënyra të mësimdhënies. Veçanërsisht janë me rëndësi reagimet e paparashikuara të cilat mund të shpiejnë nga kontrollimi i planit arsimor individual, nga ndryshimi i mënyrës së mësimdhënies ose nga ndryshimi i sjelljes sonë ndaj nxënësit.

- ▶ Që ti kuptoni disa reagime të caktuara , e domosdoshme është biseda të cilën do ta bëni me nxënësin, në realitet pyetjet të cilat do ti parashtroni, si për shembull:
 - ◆ Pse nuk më pëlqen kjo?
 - ◆ Si dëshiron ndryshe ta bësh?
 - ◆ Si është më lehtë për ty?
 - ◆ A mendon se është më mirë nëse këte e vizatojmë?

- ▶ Shënoni ndryshimet në sjelljet e nxënësit, si ka bërë diçka, çka ka bërë, çka ka thënë, si ka realizuar komunikim me të tjerët, sa ka qenë i përgatitur të pranonte tentime, sa ka qenë këmbëngulës në realizimin e detyrave, çka është ndryshe në sjelljen e tij të mëparshme dhe tani .
- ▶ Evidentimi i suksesit dhe reagimet e nxënësit do t'ju ndihmojnë në kontrollimin e përparimit individual në raport me prioritetet e parashtruara, qëllimet dhe rezultatet, ndjekja e efikasitetit të programit individual dhe lajmërimi për përparimin. Në këtë mënyrë zmadhohet numri i informatave të cilat i fitoni për nxënësin të cilat mund ti shpërndani me prindërit dhe me personat e tjerë të cilët punojnë me nxënësin.

4 Informata kthyese konstruktive

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Shumë nxënës me vështirësi në mësim japin përshkrime negative të aftësive dhe aktiviteteve. Informata kthyese konstruktive në cilën do formë, e then këtë model të vetënotës së ulët dhe frikës dhe mundëson shikim real të gjërave.

Informata kthyese është me rëndësi të veçantë për nxënësit me vështirësi në mësim për shkak se në mënyrë direkte i kyç nxënësit në procesin mësimor, i motivon dhe paraqet një lloj të përkrahjes në të mësuarit e tyre.

Informata kthyese përkrahëse ndikon për ndërtimin e vetëbesimit të nxënësi dhe dërgon mesazh të qartë se secili mundet të përparon. Për atë ajo duhet të jetë specifike për secilin nxënës - e jo krahasuese, përshkruese - e jo notuese dhe duhet të jepet në

mënyrë të thjeshtë që është e lehtë për ta kuptuar.

Gjatë mësimdhënies është mirë që shpesh të jepet informata kthyese gojore, me sygjërim se çka duhet ende të bëhet.

Informata kthyese me shkrim është veçanërisht e vlefshme për prindërit e nxënësit dhe mundëson që ata të fitojnë informata se çka nxënësi bën mirë, ku gabon, ku paraqiten vështirësi dhe ku dhe si duhet ta përmirësojnë mësimnxënien e tyre. Krahjet konkrete të dhëna në të mundësojnë që prindët të mundin të kyçen në procesin e mësimdhënies dhe të mundin të ndihmojnë fëmijën së tyre ashtu siç e bën atë arsimtari në shkollë. Informata kthyese në realitet duhet të jetë e orientuar nga procesi mësimor me çka nxënësit do të mundësohet të mëson se si të mësojë dhe vet të rishikon se çka bën mirë, e çka duhet të përmirëson.

SI TË JEPET INFORMATA KTHYESE KONSTRUKTIVE

Githmonë riktheni nxënësit – në rast se gjatë aktivitetit ose realizmit të ndonjë operacioni nxënësi bën hap të gabuar, kthehuni në hapin e tij të suksesshëm të fundit, duke i përshkruar pse ai ka qenë i suksesshëm dhe çka tani kërkohet nga ai. Në këtë mënyrë njëkohësisht i ndihmojmë nxënësit të mëson nga sukseset e tija dhe të ndjehet më i sigurtë.

- ▶ Gjenero dy deri tre gjëra të cilat nxënësi i bën mirë, dhe kanë të bëjnë me rezultatet e pritura.
- ▶ Identifikoni lëminë në të cilat nxënësi mund të përmirësohet ose diçka që mund të përmirësohet (jo gjithmonë ajo ku ai është më i pasuksesshëm).
- ▶ Jepni sygjerime për përmirësim – tregoni ose shkruani informatë e cila i tregon saktë nxënësit çka dhe si të përmirësojë.

Ka tre shkallë të dhënies të informatës kthye:

- ◆ **Rikujtimi** për atë çka pritet nga nxënësi.
- ◆ **Thënia/orientimi** – çka mund të bën ose parashtrimi i pyetjes të fokusuar.
- ◆ **Dhënia e shembujve konkret nxënësit ose** sygjerime të cilat mund ti shfrytëzon.

Çfarë lloj i informatës kthye do të jepet varet nga mundësitë e nxënësit që të vepron në baza të asaj që ka fituar si informatë kthye.

Shembujt e dhënë më poshtë ku deklaratat janë të theksuara, përmbajnë informacion që është i rëndësishëm dhe kuptimplotë për nxënësit

Rikujtim	<p><i>Mirë i radhiti shkopinjtë sipas ngjyrës në grupe.</i></p> <p>Siç të thash duheshte ti numërosh se nga sa shkopinj ka në secilin grup dhe të shkruash në fletore.</p> <p>Mundohu ta bësh atë tani.</p>
Thënie / Orientim	<p><i>Mirë i ke rradhitur shkopinjtë sipas ngjyrës në grupe.</i></p> <p><i>Siç të thash duheshte ti numërosh se nga sa shkopinj ka në secilin grup dhe të shkruash në fletore.</i></p> <p>Si mendojsh se këte duhet ta bësh? Më trego.</p>
Dhënia e shembullit	<p><i>Mirë i ke rradhitur shkopinjtë sipas ngjyrës në grupe.</i></p> <p><i>Siç të thash duheshte ti numërosh se nga sa shkopinj ka në secilin grup dhe të shkruash në fletore.</i></p> <p>Hajde të shohim bashkërisht, sa shkopinj të kaltër ka? Numëroi. Shëno tani në fletore. Sa shkopinj të kuq ka? Hajde ti numërojmë së bashku. Mirë është, tani shkruaj në fletore. Mundohu tani vetë.</p>

Nxënësit me vështirësi në mësim shpesh ballafaqohen me vetëbesim të dobët. Ata jo githmonë gjatë të mësuarit e vërejnë suksesin e tyre. Ashtu, kur fillojnë ndonjë aktivitet, njëkohësisht fillojnë edhe të kujdesen se si do ta bëjnë ate. Në rast se menjëherë nuk fitojnë vërtetim për suksesin, disa nga ata mund të shpenzojnë shumë energji në kujdesin për ate se si do të jenë reagimet e të tjerëve në rast se nuk e bëjnë diçka mirë. Për ate me rëndësi është që vazhdimisht t'ju jepni informata për suksesin e tyre, sadoqoftë të jetë i vogël.

- ▶ Jepni kohë të mjaftueshme nxënësit që të mundet ta kupton informatën kthyese (në rast se është gojore) ose ti lexon sygjerimet dhe të bën ndryshime (në rast se është me shkrim).
- ▶ Mos jepni informatë kthyese me shkrim te nxënësit ku janë të shprehura vështirësitë me të lexuarit ose të kuptuarit e të shënuarit (disleksioni, autizmi, aftësitë intelektuale të zvogëluara).
- ▶ Kur jepni informatë kthyese gojore keni kujdes në zërin me të cilin e jepni të njejtën.
- ▶ Kontrolloni se a është kuptuar mirë informata kthyese.

5 Vetënotimi dhe notimi i ndërsjelltë

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Nxënësit me vështirësi në mësim shpesh janë jokritik dhe joreal gjatë vlerësimit të aftësive dhe të arriturave vetanake (ose i nënçmojnë ose i mbivlerësojnë).

Njëri nga qëllimet e notimit formativ është aftësimi i nxënësve për vetëvlerësim dhe zhvillim të vetëdijes për kompetencat vetanake.

Kjo arrihet nëpërmjet:

- ◆ Duke ndihmuar nxënësit që ti njohin dhe zhvillojnë anët e forta të tyre,
- ◆ Përshtatja e atyre lëmive ku nxënësit janë më të dobët dhe në korniza të tyre jepen udhëzime precize,
- ◆ Ndhimë të mësojnë që përparimin e tyre ta vlerësojnë në raport me veten e jo në raport me të tjerët,
- ◆ Mësimdhënia e shkathtësive për mësim.

Një nga teknikat për përvetësimin e të lexuarit është punimi i modeleve të shkronjave nga plastelini, me çka nxënësi mëson ti njoh dhe përdor. Gjatë modelimit arsimtari nuk i përmend gabimet, por me ndihmë të pyetjeve (a je i kënaqur me ate se si duket?) nxit dhe udhëheq që ai ti njeh.

Në fund të modelimit nxënësit i jepen materiale të shkruara (fotografi, postere, enciklopedi ...) ku i njeh shkronjat dhe e krahason shkronjën me modelin e tij.

SI NXËNËSIT TË AFTËSOHEN PËR VETËNOTIM

- ▶ **Nxënësi duhet të njeh pse ndonjë aktivitet bëhet dhe çka kyç ai** (shembull: pjesëmarrja në prerjen dhe ngjitjen e letrës me ngjyrë dhe shkruarja e tekstit si rezultat ka bërjen e kartolinës për ditëlindje).

- ▶ **Ta njeh fundin e aktivitetit** (ndjekja e një vargu të shenjave – procedura si mënyrë që të arrihet rezultat i caktuar).
- ▶ **Të bën zgjedhje dhe të shpreh respektim** (Në lidhje me mënyrën e punës ose në lidhje me ndonjë aktivitet të planifikuar).
- ▶ **Ti tregon shkaqet se pse diçka më tepër dhe diçka më pak dëshiron ta bën** (shembull: më tepër dëshiron shkencat natyrore për ate se mund të punon në grup me nxënës të tjerë).
- ▶ **Ti njeh sukseset personale** (shembull. Në punën me grupin për bërjen e albumit me fotografi ka gjetur fotografi përkatëse me tekstin dhe i ka ngjitur në ata vende afër tekstit ku më tepër përgjigjen).
- ▶ **Ti njeh vështirësitë me të cilat ballafaqohet** (shembull. I di të dhënat në detyrën tekstuale, gaboj kur duhet të caktoj se cili operacion duhet të bëhet me ta).
- ▶ **Ti i identifikon dhe noton anët e veta të forta, dhe ata në të cilat ballafaqohet me vështirësi** (I mirë jam në ... më duhet ndihmë për të ...).
- ▶ Të mëson nga gabimet e veta, por më shumë nga sukseset e veta.
- ▶ **Të parashtron qëllime** (Ta parashtron pyetjen: Çka do të bëj tani? Çka dëshiroj që të bëj diçka tjetër? Dhe të përgjigjet në pyetjet e parashtruara).
- ▶ **Ta zhvillon vëmendjen dhe koncentrimin, duke përparuar nga kontrolli i jashtëm në vetëkontrollimin dhe aftësinë për të orinetuar vëmendjen nga një aktivitet -detyrë në aktivitet tjetër – detyrë.**

6 Planifikimi në bazë të refleksionit

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Për këtë pjesë është e nevojshme që të riktheheni në përmbajtjen e pjesës së 6 në Doracakun për arsimtarë për notimin formativ në mësimin klasor.

Mësuesit klasor shpesh nuk janë të trajnuar mjaftueshëm për punën me fëmijë me vështirësi në mësim, por përvoja është mësuesi i pakalueshëm. Për ate, në punën me këta nxënës është me rëndësi të veçantë arsimtari të bën refleksion për ate çka dhe si ka punuar me çdo fëmijë me vështirësi në mësim, kur ka

arritur sukses, a kur jo dhe të mundohet të gjen shkaqe pse është ajo ashtu.

7 Informimi i prindërve

PSE ËSHTË ME RËNDËSI?

Prindërit kanë të drejtë të dinë:

- ◆ çka do të mësojnë fëmijët e tyre
- ◆ si do të zhvillohet mësimi
- ◆ si do të notohen
- ◆ sa janë të suksesshëm në mësim
- ◆ çfarë përkrahje mund t'ju japin ata

Prindërit më mirë i njohin fëmijët e tyre, ata janë me ata në situata të ndryshme dhe për ate mundet të jenë burim shumë i çmueshëm i informatave për arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional në punën me nxënës me vështirësi në mësim.

Për ate, shkëmbimi i informatave për fëmijun duhet të fillon fillimisht nga prindi drejt arsimtarit, me çka arsimtari do të merr informatat e nevojshme për nxënësin dhe do të mundet të përdëftojë shkallën momentale të të arriturave. Disa nxënës nuk komunikojnë dhe nuk reagojnë në mënyrë të njejtë në shtëpi dhe në shkollë, dhe me shkëmbimin e

informatave edhe prindi edhe arsimtari kuptojnë diçka më tepër për fëmijun.

Shkëmbimi i rregullt i informatave për fëmijun ndikon në gjetjen e mënyrave të sjelljes, mësimdhënies dhe komunikimit të cilat do të jenë përkatëse me nevojat e tyre, mundësitë, dituritë dhe përvojat. Ashtu zvogëlohet mundësia që të thellohen vështirësitë në raport me të mësuarit dhe sjelljes dhe të njejtat të tejkalohen me aksion dhe besim të përbashkët.

Bashkëpunimi i mirë karakterizohet me respektim të ndërsjelltë dhe me pëlqim të ndërsjelltë në lidhje me qëllimet të cilat dëshirojmë ti arrijmë, aktivitetet e përbashkëta lidhur me ta, si dhe mënyrat e ndjekjes së të arriturave të nxënësit. Shkëmbimi permanent i informatave duhet të bazohet në komunikim të sinqertë dhe përkrahje të ndërsjelltë, sidomos në situata të vështira.

Për komunikim të mirë të domosdoshme janë shkathtësitë për dëgjim të tjerëve dhe të kuptuarit e porosive të tyre, por dhe shkathtësive për bartjen e ideve vetanake, qëllimeve dhe ndjenjave të tjerëve.

Prindët njkohësisht duhet ti parashtrojnë pyetje arsimtarit dhe të tregojnë interesim për pjesëmarrje në procesin e mësimin të fëmijëve të tyre. Kontaktet e përditshme janë mënyra më e mirë për vendosjen e komunikimit dhe bashkëpunimit me prindërit. Prindërit duhet gjithmonë të ndjehen të mirëseardhur në shkollë. Duhet të kuptohen ndjenjat e tyre dhe fakti se disa nga ta frikohen nga kontakti me arsimtarët. Prindërit e fëmijëve me pengesa në zhvillim dhe vështirësi në mësim shpesh janë ambivalent në raport me komunikimin për gjenjden dhe nevojat e fëmijëve të tyre: disa nuk dëshirojnë, nuk munden, të pranojnë se fëmiju i tyre ka problem, a të tjerë nuk dëshirojnë të bisedojnë për ate. Për ate është shumë me rëndësi të krijohen raporte të hapura dhe besueshmëri ndërmjet prindit dhe arsimtarit. Besimi dhe gadishmëria për punë ekipore në gjetjen e mënyrave më të mira që ti ndihmohet fëmijut, ndihmojnë që të tejkalohen barrierat në relacionin prind - arsimtar.

SI TË INFORMOHEN PRINDËRIT?

- ▶ Obligativisht kyçni prindërit në përgatitjen e programit arsimor individual, bisedoni dhe shkëmbeni informata për anët e forta të nxënësit dhe për nevojat dhe prioritetet e tija.
- ▶ Njoftoni ata me qëllimet dhe rezultatet e parashtruara ose bashkërisht vendosni ata në rast se është e mundur (prindit duhet ti tregoni se çka planifikoni ta mësoni fëmijën e tyre).
- ▶ Lajmëroni më konkretisht deri në çfarë shkalle ajo që është planifikuar, është realizuar – udhëhiquni nga rezultatet e parashtruara.
- ▶ Informoni prindin se në cilën mënyrë (me çfarë metode, aktiviteti) është arritur ajo.
- ▶ Bisedoni për ate se çka planifikoni në vijim të bëni dhe pse, tregoni ate që sipas programit pritni në vijim që të arrihet.
- ▶ Prindërve gjithmonë jepni ndonjë informatë pozitive për fëmijun (çka është jo që e ka bërë mirë, përmendni ndonjë talent të veçantë ose veti).
- ▶ Pyetni prindërit se çfarë ndryshimi pozitiv kanë vërejtur ata te fëmiju i tyre.
- ▶ Orientoni prindin konkretisht çka duhet të bën ai në shtëpi si plotësim i asaj që ju e bëni në shkollë.

Bashkëpunimi i afërt i prindërve me arsimtarët dhe personat tjerë profesional në shkollë mundëson zhvillim më kualitativ dhe më të mirë të personalitetit të fëmijut dhe gjendjes së tij emocionale.

8 Shtojcat

Shtojca 1 – VLERËSIMI INICUES – PROFILI I NXËNËSIT/ ANËT E FORTA – NEVOJA PËR PËRKRAHJE

ANËT E FORTA DHE INTERESIMI I NXËNËSIT	NEVOJA PËR PËRKRAHJE
<p>1. Të mësuarit dhe si mëson (Përmendni pikëpamjet për të arriturat e deri tanishme arsimore, mënyra e të mësuarit, motivimi për mësim, interesimet, shkathtësitë specifike me të cilat dallohet, si dhe ata në të cilat mbetet pas dhe ngjashëm.)</p>	
<p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Dëshiron të marr pjesë në lojëra matematikore. ◆ Operacionet matematikore mbledhje dhe zbritje deri më 1000 janë përvetësuar në masë të madhe. ◆ Zgjidh detyra të thjeshta me operacionet themelore matematikore. ◆ Zgjidh detyra numerike sipas modelit të mësuar, me sqarime plotësuese të kohë paskohshme 	<p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Përmirësim i të mbajturit mend i rregullave matematikore (nëpërmjet shfrytëzimit dhe respektimit të rregullave në lojërat matematikore) ◆ Adaptimi i detyrave me zvogëlim të numrit të operacioneve matematikore në një detyrë (vështirësi paraqiten gjatë realizimit të më tepër operacioneve matematikore në një detyrë) ◆ Të ushtruarit e tabelës së shumëzimit (me ndihmën e teknikave memoruese). ◆ Të kuptuari të detyrave tekstuale (me ndihmën e hartave konceptuale). ◆ Të kuptuari të udhëzimeve për punë nëpërmjet thjeshtësisimit dhe zbërthimit në pjesë më të vogla.
<p>2. CShkathtësitë sociale (përmendni parashikimet për raportet me të tjerët - nxënësit, arsimtarët, prindërit dsi dhe në raport me respektimin e rregullave).</p>	
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Kërkon ndihmë nga nxënësit e tjerë kur diçka nuk mund ta bën vetë. ◆ Merr pjesë në aktivitete grupore. ◆ Mundet ti përsërit rregullat për sjellje për të cilat ka pasur marëveshje që më parë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Respektimi i i rregullave të cilat janë vendosur në nivel të paraleles (me ndihmën e nxënësve tjerë dhe duke filluar në aktivitetet grupore). ◆ Kontrollimi i selljes ndaj nxënësve tjerë, veçanërisht të formave agresive të sjelljes dhe komunikimit.

3. Shkathtësitë komunikative (Përmendni parashikimet për mënyrën e shkëmbimit të informatave me të tjerët, duke kyçur edhe shkallën e njohjes së gjuhës në të cilën mëson, si dhe pengesat gjatë shfrytëzimit të mjeteve për komunikim simbolik, verbal dhe vizuel).

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ◆ është kureshtar, shpesh parashtron pyetje ◆ Realizon komunikim me nxënësit të tjerë në paralele. ◆ Më mirë mëson dhe mban mend me ndihmën e materialeve vizuale. | <ul style="list-style-type: none"> ◆ Përmirësimi i të kuptuarit të shënimeve. ◆ Zhvillimi i shkathtësive për dëgjim. ◆ Përmirësimi i mundësive për shprehje (duke filluar me parashtrimin e pyetjeve dhe të përgjigjurit e tyre në aktivitete grupore). |
|--|--|

4. Pavarësia dhe kujdesi për vete (përmendni pikëpamjet për aftësitë që nxënësi vetë të kujdeset për vete dhe ti plotëson obligimet e përditshme në shtëpi dhe në shkollë).

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ◆ është i zhvilluar orientimi në hapësirë dhe kohë. ◆ është prezent orionetimi i hapësirës punuese. | <ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxitja e pavarësisë në realizimin e detyrave, por edhe në kujdesin për vetvete (veshmbathje, mbledhje të mjeteve). ◆ Zhvillimi i shprehive për rregullshmëri (hapësira punuese shpesh është e mbingarkuar me gjëra të panevojshme – libra nga lëndët tjera , ngjyra, lapsa, etj.) |
|--|--|

5. Ndikimi i mjedisit të jashtëm ndaj mësimin (përmendni parashikimet për kushtet familjare dhe të tjera të cilat kënaqshëm dhe jo kënaqshëm ndikojnë ndaj mësimin dhe përparimit).

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxënësi jeton me dy prindër, në familje në të cilën fiton kujdes dhe motivim. | <ul style="list-style-type: none"> ◆ Udhëzimi i prindërve për mënyrat e përkrahjes të cilat mund ti japin në shtëpi dhe të cilat janë të lidhura me ata që jepen në shkollë. |
|---|---|



Shtojca 2 – PËRSHTATJA E PROCESIT MËSIMORË DHE NDJEKJA E LLOJEVE TË NDRYSHME TË PENGESAVE TË CILAT SHKAKTOJNË VËSHTIRËSI NË MËSIM

ADHD

Të gjithë nxënësit nuk i tregojnë shenjat e njejta. Te disa nga ta mund të jetë dominant vetëm mungesa e vëmendjes, te të tjerët hiperaktiviteti dhe impulsiviteti, a te disa mundet së bashku të paraqiten edhe mungesa e vëmendjes dhe hiperaktivitetit.

Karakterisiftike është:

- ▶ simtomet të shprehura të mungesës të vëmendjes dhe/ose hiperaktivitet (impulsivitet),
- ▶ vështirësi në kohëzgjatje dhe fokusim të vëmendjes (vëmendje afatshkurte, nxënësi shpejt dekoncentrohet gjatë aktiviteteve),
- ▶ vetëorientimi zhvillohet vështirë,
- ▶ dobët është zhvilluar fjalimi i brendshëm (nxënësi nuk mundet me fjalim të brendshëm vetë ta korigjon sjelljen e tij),
- ▶ lidhshmëria e materialit të vjetër me material të ri zhvillohet vështirë,
- ▶ ka mundësi të dobët për analizë të sjelljeve të mëparshme (nxënësi mund të përshkruan se çka ka ndodhur, por nuk mund të sqaron veprimet e veta).

PËRSHTATJA	NDJEKJA DHE NOTIMI	STRATEGJI DHE TEKNIKA ¹ *
<p>Hapësira Mundësoni nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ që të qëndrojnë afër jush me çka do të keni kontakt më të mirë dhe komunikim ◆ të ketë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje ◆ aktivitete të cilat mundësojnë ngritje në këmbë dhe lëvizje. <p>Sa të mundeni zvogëloni mundësinë vëmendja që mos ti tërhiqet nga zhurma ose ngjarjet përreth.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Numëroni, shënoni ose tregoni të gjitha hapat e nevojshme për realizimin e detyrës edhe ate në disa pjesë dhe në korniza kohore të pritura. ◆ Shpesh, gjatë orës mësimore, kontrolloni përparimin, kontrolloni çka ka dëgjuar nxënësi dhe çka ka kuptuar me qëllim që të mos “çkyqet” për shkak të moskuptimit. ◆ Mundësoni nxënësit ndihmë nga nxënësit e tjerë, në realitet tregoni qartë se kujt dhe si duhet ti drejtohet për ndihmë. ◆ Mundësoni kohë plotësuese për punë dhe shpërbleni për përfundimin në kohë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Vetënotim (pyetje për refleksion/vetënotim, refleksion në fillim dhe në fund të temës/detyrës – strategjia DDM, nivelet e përparimit – startegjia shkalla, video – vetënotim i sjelljes vetanake). ◆ Organizuesit grafik (semafori, hartat mendore, hartat konceptuale)

¹ Janë përmendur strategji dhe teknika të mundëshme të cilat mund të jenë të përshtatshme për ndonjë lloj të caktuar të vështirësisë dhe janë përshkruar në Doracakun për arsimtarë për notim formativ në mësimin klasor

Dhënia e udhëzimeve për punë:

- ♦ tërhiqni vëmendjen e nxënësit para se ti jepni udhëzime për punë (kërkoni që t'ju shikon, afrohuni më afër tij),
- ♦ tregoni qartë se çka pritet nga ai,
- ♦ udhëzimet jepni një nga një,
- ♦ qetë përsëritni udhëzimet edhe një herë dhe kërkoni nga ai që të përsërit se çka i keni thënë.

Materiale mësimore dhe mënyra për mësimdhënie

- ♦ mundësoni mënyra alternative të zgjidhjes së detyrave, me mundësi të reduktuara për shkruarje,
- ♦ shfrytëzoni metarial vizatimorë,
- ♦ përgatitni material të shkruar me pjesë të rëndësishme të vizatuara,
- ♦ mësoni se si ti lidh pjesët e rëndësishme në tekst,
- ♦ kombinoni aktivitete dhe metoda prezantuese gojore, vizuele, të shkruara,
- ♦ kërkoni nga nxënësi ta përsërit atë që është thënë, shfrytëzoni pyetje dhe diskutim,
- ♦ mësimdhënie për shfrytëzim të teknikave memoruese,
- ♦ Jepni detyra të cilat kërkojnë aktivitete (lëvizje) motorike

- ♦ Shfrytëzoni afërsi fizike – prekje për orientim të aktivitetit të nxënësit, shpërbleni vëmendjen e tij.
- ♦ Në materialet të shkruara për kontrollim të diturive leni vend të mjaftueshëm për përgjigje (shpesh shkrimi karakterizohet me shkronja të mëdha dhe jo të barabarta).
- ♦ Notoni përmbajtjen dhe jo shkrimin.
- ♦ Mundësoni nxënësit që të kyçet në mënyrë aktive në diskutim.
- ♦ Mësoni atë me metodat e vetëorientimit dhe vetënotimit, nxitni ndërprerje të punës dhe kontrollim të asaj që është punuar.
- ♦ Jepni informata të vazhdueshme dhe në kohë për:
 - » Ndryshimi i aktiviteteve (ke edhe pesë minuta që të kryesh këtë detyrë dhe ta fillosh tjetrën);
 - » Të priturat të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin vijues, si dhe për mjetet dhe të gjitha hapat e nevojshëm për realizimin e të njejtës (*shembull. Për detyrën vijuese duhet të shfrytëzosh metër, laps dhe fletore. Në fillim duhet ta matish gjatësinë e bankë, pastaj ...*).
- ♦ Jepni informata kthyes shpesh qartë dhe konkretisht, të cilat kanë të bëjnë me të ariturat.

- ♦ **Notimi i ndërsjelltë, diskutimi** (nxënësit parashitjnë pyetje njëri tjetrit, çek lista për vëzhgim)
- ♦ **Portfolio**
- ♦ **Markuesit kohorë** gjatë kontrollimit me shkrim me qëllim që të ndihmohet gjajët organizmit të kohës

DISGRAFIA DHE DISLEKSIA

Ka çregullim të të lexuarit dhe të shkruarit e cila ndryshohet me ritje - zhvillim (mund të përvetësohet shpejtësia dhe saktësia e të lexuarit, por jo edhe të kuptuarit e asaj që lexohet). Sipas rregullës ata paraqiten së bashku.

Karakterisiftike është:

- ▶ спора синтеза и анализа,
- ▶ sinteza dhe analiza e ngadalshme,
- ▶ të haruarit, ndërimit, të shtuarit e shkronjave, rrokjeve ose fjalëve gjatë të lexuarit dhe të shkruarit,
- ▶ rrotullimi i shkronjave gjatë të shkruarit,
- ▶ mosrespektimi i reshtit dhe hapësirës në fletë gjatë të lexuarit dhe të shkruarit,
- ▶ jorregullshmëri në shkrim, veçanërisht jobarabarshmëri të madhësisë së shkronjave dhe këndit të të shkruarit,
- ▶ moskuptimi i asaj që është lexuar dhe i informatave të pranuar,
- ▶ vështirësi në caktimin e radhitshmërisë (i pari/i fundit, majtas/djathtas),
- ▶ ngadalshmëri, fond i vogël i fjalëve moskuptimi i sinonimeve, metaforave, homonimeve,
- ▶ te nxënësi shpesh është prezente disproporcioni ndërmjet të shprehurit verbal dhe joverbal.

PËRSHTATJA	NDJEKJA DHE NOTIMI	STRATEGJITË DHE TEKNIKAT
<p>Hapësira</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Mundësoni nxënësit që të ulet afër tabelës dhe afër juve <p>Dhënia e udhëzimeve për punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ kërkoni nga nxënësi që ta përsëris udhëzimin dhe kontrolloni se a e ka kuptuar. <p>Materialet mësimore dhe mënyrat e mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ planifikoni më tepër kohë për përvetësimin e disa temave ◆ shfrytëzoni lloje të ndryshme të përkrahjeve për zhvillimin e përmbajtjeve të reja - pamore, dëgjuese, prekëse (foto të gjësendeve, modelim të shkronjave dhe numrave) ◆ zvogëloni madhësinë e tekstit 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Shfrytëzoni më shpesh forma gojore në mësimdhënie dhe në kontrollimin e diturive. ◆ Në mënyrë sistematike kontrolloni se a e kupton nxënësi përmbajtjen, konceptet, përkufizimet dhe jepni sqarime plotësuese. ◆ Mos tentoni që nxënësin ta vëndoni në situatë të lexon ose të shkruan në tabelë para tërë paraleles (vetëm në rast se nxënësi nuk shpreh vetëdëshirë). ◆ epni numër më të vogël të detyrave, rradhitni ashtu që në fillim do të jepni detyrë më të lehtë pastaj më të vështirë dhe në fund përsëri më të lehtë. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Organizues grafik (semafori, harta mendore, rrjeti i tregimit, hartat konceptuale, këndi i drejtë) ◆ Notimi i ndërsjelltë (ndarja në çifte dhe të shënuarit e përgjigjeve) ◆ Vetënotimi (nivelet e përparimit - strategjia shkalla) ◆ Informata kthyes gojore dhe notimi i suksesit të hapave në procesin e të shkruarit.

<ul style="list-style-type: none"> ◆ kërkoni nga nxënësi gjatë leximit të shfrytëzon shënues të tekstit (mund të jetë kartuç ose fletë letre e vogël me të cilën do ta mbulon tekstin të cilin nuk e lexon dhe ashtu vëmendjen e vet do ta orineton nga teksti të cilin e lexon) ◆ sqaroni konceptet e panjohura në tekst ◆ shfrytëzoni tekste më të thjeshta dhe të përpunuara ◆ ndihmoni që në libër qartë ti shënon pjesët të cilat janë të rëndësishme (shembull. Rregull, shembull, mënyrë, foto) ◆ Sfrutëzoni shembuj konkret fotografi, tendenca lidhur me tekstin, mësoni nxënësin që ti mëson teknikat e vizuelizimit dhe të mbajturit mend më të shpejtë, si dhe të mëson me ndihmën e hartave konceptuale. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ndani aktivitetin/detyrën në më tepër faza. ◆ Mos e kufizoni në kohë zgjidhjen me shkrim të detyrave dhe mos i notoni gabimet të cilat janë rezultat i disleksionit. ◆ Mos i përmirësoni gabimet gjatë shkruarjes, por vetëm shënoni dhe kërkoni që nxënësi vetë ti përmirëson me ndihmën e librit, fjalorit ose me ndihmën tuaj. ◆ Jepni kurajo nxënësit që spontanisht të shprehet dhe nxitni pavarësinë e tij në punë. ◆ Përgatitni pyetje të cilat kanë të bëjnë me tekstin dhe e ndjekin atë – në këtë mënyrë nxënësi më lehtë mundet të koncentrohet në tekst dhe ta përmirëson të kuptuarit e asaj që e lexon. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Diskutimi dhe dhënia e informatës kthyeje gojore për rrjedhën e diskutimit.
--	---	--



DISKALKULIA

Vështirësitë në përvetësimin e diturive matematikore dhe gjuhës matematikore, të cilat kufizohen nga vështirësitë në të shkruarit e shifrave dhe numrave deri në pamundësinë për të kuptuarit dhe të përvetësimit të koncepteve dhe proceseve matematikore

Karakterisitike është:

- ▶ ndërimi i njërit numër me numër tjetër,
- ▶ përsëritje e një numrit ose operacionit disa herë,
- ▶ të shikuarit e numrave dhe shenjave në “pasqyrë” (të rrotulluara),
- ▶ ngadalshmëria,
- ▶ vendosja e numrave në pozitë hapësinore jo të përshtatshme,
- ▶ gabime vizuale (në vend të shenjës „+“ nxënësi shikon shenjën „-“),
- ▶ gabime procedurale (kërcehen hapa gjatë procedurës),
- ▶ vështirësi në të mbajturit mend të vargut të numrave,
- ▶ paaftësi për të kryer operacione të thjeshta matematikore (nxënësi e kupton logjikën e këtyre operacioneve, por nuk mundet në mënyrë automatike të rikujtohet në faktet, dhe për ate deri në zgjidhje të detyrës vjen me numërim, ai nuk i haron numrat, por skemat në të cilat duhet ti vendos),
- ▶ vështirësi në planifikim (nxënësi nuk e analizon detyrën, por menjëherë fillon me zgjidhjen pa menduar se çka kërkohet në detyrë dhe si duhet të zgjidhet, vështirë kupton se si janë të lidhura elementet në detyrë dhe në çfarë rradhitje duhet të punohet)
- ▶ vështirësi në kontrollimin e detyrave.

SHTOJCA	NDJEKJA DHE NOTIMI	STRATEGJITË DHE TEKNIKAT
<p>Dhënia e udhëzimeve për punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ sigurimi i udhëzimeve të detajuara për punë ◆ për shkak të vështirësive në logjikën të cilat kyçin mos të kuptuarit e shprehjeve dhe raporteve hapësinore (shembull. Vizato drejtëkëndësh mbi trekëndëshin) jepni udhëzime gojore gjatë së cilës do të keni kujdes në rradhitjen e elementeve - nxënësi i vëren elementet sipas asaj rradhitje siç janë emëruar, por nuk ka kujdes në raportet hapësinore në të cilat janë treguar ata (shembull. Vizaton drejtëkëndësh dhe afër tij trekëndësh). 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Jepni numër më të vogël të detyrave, radhitni ashtu që në fillim do të jepni detyrë më të lehtë, pastaj më të vështirë dhe në fund përsëri më të lehtë. ◆ Ndani aktivitetin/detyrën në më tepër faza. ◆ Ndiqni aspekte të ndryshme nga matematika (njehsim, paraqitje, organizim). ◆ Vazhdimisht ndiqni punën e nxënësit dhe jepni informatë kthyesë. ◆ Mundësoni përdorimin e kompjuterit, digitronit, materialeve plotësuese punuese me tabelë shumëzimi, formula... 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Organizuesit grafik (diagramet, skemat, hartat konceptuale, paraqitjen me vizatime të detyrave tekstuale) ◆ Gishtat dhe manipulativet ◆ Teknikat memoruese gjatë të mësuarit të hapave në konceptet matematikore ◆ Ritmi dhe muzika për të mësuarit e koncepteve matematikore dhe hapave në operacione

Materiale mësimore dhe mënyra për mësimdhënie:

- ◆ kombinoni numra ose simbole me fjalë (+, plus), (7, shtatë)
- ◆ përdorni ngjyra të ndryshme që të shënohen fjalë të caktuara, simbole, operacione
- ◆ nxitni nxënësin të flet për procesin e punës, të sqaron se çka bën
- ◆ zvogëloni gabimet gjatë përshkrimit me atë që do ti siguroni që më parë material të përgatitur
- ◆ motivoni nxënësin dhe udhëzon që në fillim të kryen vlerësim, qasje në kërkesën e detyrës, para se të fillon të njehson
- ◆ bëni ju dhe udhëzoni nxënësin të bën asociacione vizuele për operacione ose simbole të caktuara

- ◆ Bëni reduktimin e detyrave në test dhe siguroni kohë plotësuese për punë.

- ◆ **Strategjitë për zgjidhjen e testeve** (gjindshmëria në situatat e testit).



AFTËSITË INTELEKTUALE TË ZVOGËLUARA

Karakteristikat zhvillimore kanë të bëjnë me kufizimet në funksionimin intelektual dhe sjelljen adaptuese.

Karakteristike është:

- ▶ vështirësi gjatë realizimit të operacioneve të ndryshme mendore (gjeneralizimi, apstrahimi, analiza, lidhshmëria dhe realizimi, përfundimi, zgjidhja e problemeve) të cilat dukshëm e vështirësojnë përvetësimin e përmbajtjeve abstrakte në mësim,
- ▶ vështirësi në lëminë e perceptimit, të mbajturit mend, vëmendjes, ekspresionit gojor,
- ▶ në lëminë e sjelljes adaptuese karakteristike janë kufizimet në pjesën e komunikimit, kujdesit për vehte, shkathtësitë sociale, vetëorientimi, dituritë funksionale.

PËRSHTATJA	NDJEKJA DHE NOTIMI	STRATEGJITË DHE TEKNIKAT
<p>Dhënia e udhëzimeve për punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ jepni udhëzime dhe kahje të qarta, konkrete dhe të thjeshta për punë ◆ udhëzimet jepni në madhësi më të vogla, një nga një ◆ kyçni nxënësin vetëm në detyra praktike të thjeshta gradualisht, me sqarime të qarta. <p>Materialet mësimore dhe mënyrat mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ programi individual duhet të bazohet fillimisht në vlerësimin inicues të diturive, aftësive dhe shkathtësive të nxënësit dhe të parasheh përvetësimin e numrit më të vogël të fakteve, gjeneralizimeve, a veçanërisht abstraksioneve 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Sa më shpesh shfrytëzoni bisedë, gjatë së cilës me rëndësi është përdorimi i pyetjeve të cilat do ti parashtroni në më shumë mënyra, me të cilat nxënësit do ti ndihmoni që ta gjejnë përgjigjen e vërtetë. ◆ Për të gjitha lëndët mësimore caktoni sasinë dhe komplikueshmërinë e përmbajtjeve sipas aftësive për lexim të nxënësit. ◆ Gjatë të lexuarit mundësoni nxënësit shfrytëzim të orientuesit ◆ Gjatë përshkrimit të tekstit më të gjatë, mundësoni nxënësit përshkrim të vetëm një pjese ose përmendni vetëm fjalitë e rëndësishme të cilat do ti përshkruan. ◆ Gjatë diktimeve përshtatni tempon dhe gjatësinë e tekstit në aftësitë e nxënësit dhe kur është e mundshme realizoni diktim selektues. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Oragnizuesi grafik (trekëndëshi, DDM, semafori) ◆ Luajtja e roleve ◆ Portfolio ◆ çek listat për ndjekje ◆ Vetënotimi – grumbullimi i të dhënave për sjelljen vetanake (tabela, grafike, ngjitëse)

- ◆ përmbajtjet për mësim përgatitni në mënyrë të thjeshtë, me më pak detaje dhe më shumë lidhni me nevojat nga jeta e përditshme e nxënësit dhe mundësitë për zbatimin e tyre
- ◆ zbërtheni kuptimet e zgjeruara, detyrat, aktivitetet në pjesë, dhe pastaj formoni në tërësi përmbajtësore
- ◆ gjatë të mësuarit të pavarur, në tekst shënoni ato që është me rëndësi, tekstin shkurtoni ose thjeshtësoni me përdorim të fjalëve të njohura dhe fjalive të shkurta, udhëzoni në shfrytëzim të hartave konceptuale të thejshta
- ◆ mos kërkoni nga nxënësi të shkruan gjatë kohës në mësim, për te përgatitni materiale të gatshme.
- ◆ Gjatë të shkruarit të hartimeve me shkrim jepni nxënësit kahje të thjeshta dhe rikujtoni në rregullat drejtshkrimore ku më tepër ka gabuar.
- ◆ Kryeni kontrollime të shpeshta dhe të shkurtëra të pjesëve më të vogla dhe mundësoni nxënësit atë mënyrë të kontrollimit që është më e lehtë (gojor, me shkrim).
- ◆ Jepni numër më të vogël të detyrave me operacione të thjeshta matematikore.
- ◆ Pyetni shpesh se si ka aritur deri te përgjigjja dhe kur mënyra nuk është e përshtatshme orientoni në mënyrat tjera të zgjidhjes.
- ◆ Motivoni vazhdimisht nxënësin.

AUTIZMI

Vështirësia kyçe me të cilën ballafaqohen prindërit dhe arsimtarët në punën me fëmijët me autizëm është se si të tërhiqet vëmendja e tyre me qëllim që të sigurohet komunikim efikas. Fëmijët me autizëm jetojnë në botën e tyre dhe vështirë është të arihet deri atje, prandaj pikërisht aftësia për vëmendje është kyçe për zhvillimin e aftësive tjera.

Karakteristikat e kësaj sëmundjeje janë:

- ▶ specificiteti në raport me perceptimin, përjetimi i mjedisit, të mbajturit mend dhe emocionet,
- ▶ mungesa e kujdesit për udhëzime dhe informata relevante, veçanërisht gjatë ndjekjes së udhëzimeve më të zgjeruara,
- ▶ vështirësi në të kuptuarit e komunikimit verbal dhe joverbal, veçanërisht me përdorimin e të shprehurit që ka të bëjnë me të shprehurit e koncepteve abstrakte,
- ▶ vështirësi gjatë formimit të të menduarit dhe përfundimit abstrakt për dallim nga të menduarit konkret, të mbajturit mend mekanik dhe të kuptuarit e raporteve vizuale - speciale,
- ▶ vështirësi në interaksionin social në orientimin e vëmendjes në persona tjerë dhe në emocionet e tyre, si dhe në të kuptuarit e ndjenjave të tjerëve,
- ▶ jo aftësia për planifikim, organizim dhe zgjidhje të problemeve,
- ▶ hapësirë e kufizuar e interesimit dhe formave jofleksibile të sjelljes (duket sikur fëmiju nuk ju shikon, nuk ju dëgjon, sikur nuk është i vetëdijshëm për prezencën tuaj, dhe në tentimet tuaja për ta mësuar diçka mund t'ju përgjigjet me pakënaqësi dhe reagim stuhik).

SHTOJCA	NDJEKJA DHE NOTIMI	STRATEGJITË DHE TEKNIKAT
<p>Hapësira</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Mundësia që gjatë shqetësimit të jetë në hapësirë të qetë, ku njëkohësisht mund të lëviz <p>Dhënia e udhëzimeve për punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ zbërtheni udhëzimet në hapa të vegjël ◆ mbështetni udhëzimet gojore me shenja dhe prezantime vizuale. <p>Materiale mësimore dhe mënyra të mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ realizoni programë për ushtrime për tërheqjen e vëmendjes, 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Praktikoni përkrahje të vazhdueshme të paramenduar. Për shkak se këta nxënës nuk mundet të motivohen me përkrahje të zakonshme si nxënësit e tjerë, mirë është që te fëmiju te identifikohet se çka është ajo që ndikon te ai si përkrahje, për të cilat informatat shpesh mundet ti fitoni nga nxënësi ose prindi. ◆ Planifikoni detyra me peshë të përshtatur për nxënësin. Më së miri është që të parashtrihen në mënyrë vizuale. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Më shumë dua – më pak dua (identifikimi i llojit të përkrahjes) ◆ Lëvdata konkrete gjatë të mësuarit (shembull. Mirë e ngjyrore topin; bravo, saktë e ke shkruar emrin dhe mbiemrin tënd) ◆ Vetënotimi – grumbullimi i të dhënave për sjelljen vetanake (tabela, grafike, ngjitime)

<ul style="list-style-type: none"> ◆ nxitni me mjete vizuele – gjësende, fotografi, inçizime, vizatime, simbole grafike (për shembull. Rregullat për sjellje përveç se me tekst të shkruar paraqiti edhe me vizatime) ◆ përkrahja fizike – orinetoni nxënësin se si të bën ndonjë aktivitet të caktuar – fillon me përkrahje të plotë fizike, dhe nëpërmjet përkrahjes së pjesërishtme shkon deri në nxitje pa përkrahje ◆ sigurimi i prezencës (komplet i sjelljeve të cilat kur do të përvetësohen i mundësojnë nxënësit me kujdes ta ndjek arsimtarin dhe detyrat) – qëndrim i drejtë, shikim në sy, dëgjim pa të folur ◆ organizoni materialet mësimore dhe situatat ashtu që do ta përmendni më të rëndësishmen (shembull. Në vend të tërë librit, vendosni para tij vetëm tekstin në të cilin doni të punoni) ◆ respektoni ritualet të cilat i posedon (shprehitë që gjërat e caktuara vazhdimisht i bën në mënyrë të njëjtë dhe me radhitje të njëjtë), mos i çregulloni me detyra të reja të papritura ◆ imitimi joverbal ◆ imitimi verbal ◆ metoda e tentimeve të vazhdueshme – nxitje, përgjigje, pasojë ◆ mësoni nxënësin se si të bën zgjedhjen e aktiviteteve 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Siguroni kohë të mjaftueshme për përgjigje dhe kohë të mjaftueshme ndërmjet dhënies së udhëzimit dhe reagimit (përgjigjes) të nxënësit. ◆ Zbërtheni detyrat/aktivitetet në hapa më të vegjël, për çdo hap mësoin dhe ndiqni përparimin para se të kaloni në hapin vijues. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ çek lista për vëzhgim
---	--	--

LITERATURA

1. GUIDELINES ON THE PROCESS OF INDIVIDUAL EDUCATION PLAN, National Council for Special Education, Co. Meath, Republic of Ireland, www.ncse.ie
2. Mastropieri M., Scruggs T., The inclusive classroom – strategies for effective differentiated instruction, Pearson Education, New Jersey, 2010.
3. Salend S., Creating inclusive classroom: effective and reflective practices, Pearson Education, New Jersey, 2011.
4. Swainger J., Williams M, Шчекиќ Д., Приручник за учење усмјерено на ученика, CARDS Пројекат, Подгорица, 2008.
5. Supporting Students with Learning Disabilities, A Guide for Teachers- http://www.bced.gov.bc.ca/specialed/docs/learning_disabilities_guide.pdf
6. TEACHING STUDENTS WITH AUTISM – A RESOURCE GUIDE FOR SCHOOLS - <http://www.bced.gov.bc.ca/specialed/docs/autism.pdf>
7. Јакубовић Е., Кратке упуте за рад са дјецом са тешкоћама у учењу и развоју, Сарајево, 2013, <file:///C:/Documents%20and%20Settings/user/My%20Documents/Downloads/kratke%20upute%20za%20rad%20sa%20djecom%20sa%20teskocama%20u%20ucenju%20i%20razvoju.pdf>
8. Лазор М., Марковиќ С., Николиќ С., Приручник за рад са децом са сметњама у развоју, Новосадски хуманитарни центар, Нови сад, 2008.
9. Приручник о дислексији, дисграфији и сличним тешкоћама у читању, писању и учењу, Загреб, 2005 - <http://www.monkstk.ba/attachments/article/115/disleksija.pdf>
10. <http://ldaamerica.org/category/assessment-evaluation/assessment-evaluation-for-educators/>

ISBN 978-608-206-051-4